

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5586  
E mërkurë, 26 shtator 2018  
çmimi 0.40 €

## Ministri Tahiri: 'Drejtësia 2020' do t'u japë fund lëndëve të vjetra



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", KORAB SEJDIU | FAQE 4-5

# Protesta, e vetmja rrugë për ta kundërshtuar pushtetin

Deputeti i pavarur në Kuvendin e Kosovës, Korab Sejdiu, ka treguar arsyen pse më 29 shtator do të jetë pjesë e protestës së thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje. Ai ka thënë se është nevojë urgjente për mobilizim qytetar kundër të keqes që ka kapluar çdo pore të shoqërisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sejdiu ka thënë se protesta ka mbetur i vetmi institucion kushtetues në dispozicion për qytetarët dhe opozitën. "Këtë protestë nuk e shoh si iniciativë të një subjekti politik, por si një mobilizim qytetar kundër të keqes", ka deklaruar Sejdiu, i cili ka treguar se është duke shtyrë përpara idenë e bashkimit opozitar dhe krijimit të



një aliance të kësaj opozite me qytetarët, për ta luftuar të keqen. "Besoj se kemi afirim dhe koordinim të pozicioneve në mes të grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht LDK-së dhe LV-së, përfshirë këtu edhe mua", është shprehur deputeti Sejdiu

DEMOKRACIA PËR ZHVILLIM (D4D) KA MBAJTUR TRYEZËN 'REFORMA ZGJEDHORE E PAPËRFUNDUAR: ÇFARË MË TUTJE?'

## Reforma zgjedhore të kthehet për diskutim në Kuvend



Kthimi i agjendës së reformës zgjedhore për diskutim në Kuvendin e Kosovës dhe përfshirja e spektrit politik janë thelbësore që reforma zgjedhore të marrë formë dhe të kontribuojë për një proces zgjedhor i cili do të prodhonte institucione kredibile. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e subjekteve politike dhe të shoqërisë civile në tryezën e organizuar të martën nga Demokracia për Zhvillim (D4D) lidhur me ecurinë e procesit të reformës zgjedhore



**BIK-u i shpall zgjedhjet për Kuvend dhe për myfti**

FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## AKTUALE



**MAQEDONIA NË NATO DHE BE, FITORE PËR POPULLIN SHQIPTAR** F. 10

Ismet SYLEJMANI

**THAÇI TAKOHET ME MBRETIN ABDULLAH II TË JORDANISË, MERR MBËSHTETJE PËR INTERPOL** F. 2

**ISMAILI: S'DO TË KETË REFORMË NË SHËNDËTËSI PA RITJEN E PAGAVE PËR MJEKËT** F. 3

## EKONOMI

**'KRU PRISHTINA': KUSH KA DY FATURA TË PAPAGUARA DO TË MBETET PA UJË** F. 8

## KULTURË

**PËRJETËSOHET VEPRA E DËSHMORIT AHMET ALUSH PANTINA** F. 20

**PROMOVHET LIBRI MONOGRAFIK 'AGIMI I LIRISË'** F. 11

## SPORT

**ADAM ROCZEK: DO TA NDIHMOJMË ZHVILLIMIN E SPORTIT TË KOSOVËS** F. 16



# Krerët shtetërorë të Republikës së Kosovës në Nju Jork kanë vazhduar takimet me liderë të ndryshëm botërorë

## Thaçi takoi mbretin Abdullah II të Jordanisë, merr mbështetje për Interpol

Në takim me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, mbreti Abdullah II i Jordanisë ka theksuar se Republika e Kosovës mund të llogarisë në mbështetjen e Jordanisë për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i cili po udhëheq delegacionin e Kosovës në sesionin vjetor të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ka takuar të martën edhe mbretin Abdullah II të Jordanisë. Me këtë rast, presidenti Thaçi i ka shprehur mirënjohje Jordanisë për mbështetjen e vazhdueshme për forcimin e shtetësisë së Kosovës, përmes shtimit të numrit të njohjeve dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Presidenti Thaçi dhe mbreti Abdullah II i Jordanisë kanë biseduar edhe për mundësinë e rritjes së bashkëpunimit ekonomik, shkëmbimit tregtar, bashkëpunimit në fushën e sigurisë si dhe rritjes së bashkëpunimit në fusha të tjera. "Kosova ka nevojë për mbështetjen e Jordanisë për ta jetësuar anëtarësimin në Interpol, gjithashtu për të lobuar te vendet e

ndryshme për rritjen e numrit të njohjeve për Kosovën", ka thënë presidenti Thaçi. Ndërsa mbreti Abdullah II i Jordanisë ka theksuar se Republika e Kosovës mund të llogarisë në mbështetjen e Jordanisë për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare.

### Thaçi kërkon mbështetjen e Organizatës për Bashkëpunim Islamik

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, bashkë me kryeministrin Ramush Haradinaj dhe zëvendëskryeministrin e parë, Behgjet Pacolli, kanë zhvilluar një takim me sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës për Bashkëpunim Islamik (OBI), Yousef bin Ahmad Al-Othaimeen, me të cilin kanë biseduar për mundësinë e thëllimit të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe 57 shteteve anëtare të kësaj

organizate.

Kreu i vendit tonë ka kërkuar nga sekretari Al-Othaimeen mbështetjen e OBI-it në procesin e shtimit të njohjes për Republikën e Kosovës, për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Interpol dhe organizata tjera ndërkombëtare. "OBI edhe në të kaluarën ka mbështetur Republikën e Kosovës në shtimin e njohjes dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Presim vazhdimin e mbështetjes tuaj", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim Islamik (OBI), Yousef bin Ahmad Al-Othaimeen ka thënë se kjo organizatë do të vazhdojë mbështetjen e gjithëmbarshme për Kosovën.

Presidenti Thaçi do t'i vazhdojë takimet me përfaqësues të shteteve të ndryshme të botës, për ta shtyrë përpara agjendën e bashkëpunimit bilateral, të shtimit të njohjeve dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Presidenti Thaçi të martën ka

takuar edhe presidenten kroate Kolinda Grabar-Kitaroviç, me të cilën ka bashkëbiseduar për thellimin e marrëdhënie bilaterale, rritjen e shkëmbimit tregtar si dhe mbështetjen për integrimet euroatlantike të Kosovës.

Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova është mirënjohëse ndaj Kroacisë për ndihmën e jashtëzakonshme në shtet-ndërtimin e Kosovës, forcimin e demokracisë, sigurimin e një të ardhme të sigurt në rrugën euroatlantike, veçmas në BE dhe NATO.

## Kryeministri Haradinaj vizitoi Akademinë Ushtarake 'West Point'



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, gjatë vizitës zyrtare që është duke e zhvilluar në ShBA, është pritur në Akademinë Ushtarake "West Point" nga gjeneraljejtënant Darryl A. Williams me bashkëpunëtorë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj, falënderoi gjeneralin Williams për pritjen dhe për ndihmën që është duke e dhënë kjo Akademi për ngritjen e kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,

përmes ofrimit të studimeve për kadetët kosovarë, e që aktualisht këtë Akademi janë duke u shkolluar dy kadetë të FSK-së, Arnela Shala dhe Ylli Dalladaku. "Vendi ynë është falënderues për gjithë kontributin që ka dhënë Amerika, si në kohë luftime po ashtu edhe paqëje. Jemi përherë mirënjohës që i kemi aleat të fuqishëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës", tha Haradinaj. Kryeministri Haradinaj, duke folur para përfaqësuesve të

"West Point Academy", për transformimin e FSK-së në ushtri, tha se Kosova është e gatshme që ta ketë ushtrinë, e cila do t'i kontribuonte paqes dhe sigurisë në vend dhe më gjerë. Gjeneraljejtënant Darryl A. Williams, pasi falënderoi kryeministrin Haradinaj për vizitën, tha se Kosova do ta ketë mbështetjen e rezervës të këtij institucioni përmes ofrimit të trajnimeve dhe studimeve ushtarake për pjesëtarët e FSK-së.

## Ahmeti: Ligji për gjuhët zyrtarizohet pas referendunit

SHKUP, 25 SHTATOR - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka deklaruar se Ligji për gjuhët në Maqedoni do të zyrtarizohet pas referendunit për emrin, i cili do të mbahet më 30 shtator. Ai ka thënë se bojkoti i opozitës është armë e atyre që nuk ia duan të mirën Maqedonisë.

"Ne nuk mund të lejojmë që në këto hapësira të luhet vallja e tjetërkujt. Vullneti ynë i fortë është që të jemi pjesë e NATO-s dhe BE-së. Nuk kemi të ardhme jashtë BE-së. Duam të jemi pjesë e përparimit dhe zhvillimit, duam të jemi pjesë e Aleancës, qytetarët tanë t'i përgjigjen pozitivisht 30 shta-

torit dhe të votojnë për marrëveshjen, të votojnë për NATO-n, të votojnë për BE-në, të votojnë për paqen, stabilitetin, sigurinë, ardhmërinë, sundimin e ligjit dhe shtetit ligjor". "Bojkoti është arma e të ligut, bojkoti nuk është kategori e demokracisë që ne e kemi instaluar në vend. Nga ne pritet

që më 30 shtator t'i gëzohemi suksesit, të gjithë të dalim e të propagandojmë e të votojmë për Maqedoninë në NATO. Pas referendunit nënshkruhet nga kryeparlamentari marrëveshja e arritur në Prespë dhe Ligji për gjuhët, që të dy botohen në Gazetën Zyrtare dhe hyjnë në fuqi", ka thënë Ahmeti gjatë një



takim me qytetarët e Komunës Saraj, në kuadër të fushatë për referendunit.



Demokracia për Zhvillim (D4D) ka mbajtur tryezën "Reforma zgjedhore e papërfunduar: Çfarë më tutje?"

## Reforma zgjedhore të kthehet për diskutim në Kuvend



Kthimi i agjendës së reformës zgjedhore për diskutim në Kuvendin e Kosovës dhe përfshirja e spektrit politik janë thelbësore që reforma zgjedhore të marrë formë dhe të kontribuojë për një proces zgjedhor i cili do të prodhonte institucione kredibile. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e subjekteve politike dhe të shoqërisë civile në tryezën e organizuar të martën nga Demokracia për Zhvillim (D4D) lidhur me ecurinë e procesit të reformës zgjedhore

sishëm për të gjitha komunitetet në Kosovë. Ajo ka theksuar se reforma zgjedhore duhet t'i trajtojë me kujdes votat e pavlefshme, zonat zgjedhore dhe listat zgjedhore. Ndërsa përfaqësuesit e subjekteve politike, ndonëse kanë pasur mospajtime për kohën e duhur për fillimin e reformës zgjedhore, kanë vlerësuar se Kosova ka nevojë për reformë zgjedhore meqë, sipas tyre, një proces i vonuar i reformës po reflektohet edhe tek legjitimiteti i institucioneve shtetërore.

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Arsim Bajrami, ka thënë se reforma zgjedhore nuk është veç nevojë, është domosdoshmëri e kohës. Ai ka theksuar se vullneti politik i subjekteve politike është element kyç për çarjen përpara të këtij procesi. "Koha më e përshtatshme është tash, që ta fillojmë këtë proces", është shprehur Bajrami. Ndërkaq deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albulena Haxhiu, ka thënë se reforma zgjedhore është çështja më e keqpërdorur politikisht nga partitë politike. Ajo ka bërë me dije se LV-ja është për zgjedhje të

jashtëzakonshme meqë, sipas Haxhiut, një legjitimitet i ri i Kuvendit do të mund ta adresonte reformën. "Më mirë për të gjithë është që të shkojmë në zgjedhje dhe një legjitimitet i ri i Kuvendit do të mund ta adresonte reformën zgjedhore", ka deklaruar Haxhiu.

Kurse nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, ka bërë thirrje që të gjitha partitë të përfshihen në procesin e reformës zgjedhore. "Partitë, pozitë e opozitë, duhet të përfshihen në procesin e reformës zgjedhore. Jemi pro reformës zgjedhore. Sa më shumë përsoset ky proces, aq më kredibile do të jenë institucionet. Përfshirja e diasporës në votime duhet të trajtohet me kujdes gjatë procesit të reformës zgjedhore", ka theksuar Isufi. Edhe deputeti i Nismës Socialdemokrate, Enver Hoti, ka thënë se reforma duhet të ndodhë dhe se tani është koha e duhur për këtë proces. "Duhet të ndodhë reforma zgjedhore. Listat e votuesve, votimet e pavlefshme, votimet me kusht, votimi i diasporës e deri të trupa zgjedhore, duhet të jenë elemente që duhet të trajtohen nga

reforma zgjedhore", është shprehur Hoti.

Edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë konsideruar se tanimë është koha për fillimin e reformës zgjedhore, duke inkurajuar arritjen e konsensusit politik si parakusht për përfundimin me sukses të këtij procesi. Gjatë kësaj tryeze të pranishmit kanë theksuar se reforma duhet ta përfshijë trajtimin me ligj të financimit të partive politike, deklarimin e financave të kandidatëve të partive politike si dhe të drejtën e auditorit gjeneral për t'i caktuar auditorët për auditimin e partive. Po sipas tyre, duhet të trajtohet me kujdes të shtuar edhe dekriminalizimi i politikës përmes nxjerrës së ligjit të ri. Ata kanë thënë se votimi elektronik dhe angazhimi i organeve të drejtësisë do të ishin elemente qenësore që do të ndikonin në një proces të mirëfilltë zgjedhor. Gjithashtu është kërkuar që gjatë procesit të reformës zgjedhore të merren parasysh edhe lista e votuesve, votimi përmes postës, dizajni i fletëvotimeve si dhe përgjegjësit e KQZ-së ndaj votuesve brenda dhe jashtë Kosovës.

### **EPOKA ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Demokracia për Zhvillim (D4D) të martën ka organizuar tryezën "Reforma zgjedhore e papërfunduar: Çfarë më tutje?", ku përfaqësues të shoqërisë civile dhe të partive politike kanë diskutuar rrugën që do të çonte drejt një reforme zgjedhore që do të ishte në funksion të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Nga të pranishmit është konstatuar se kthimi i agjendës së reformës zgjedhore për diskutim në Kuvendin e Kosovës dhe përfshirja e spektrit politik janë thelbësore që reforma

zgjedhore të marrë formë dhe të kontribuojë për një proces zgjedhor që do të prodhonte institucione kredibile.

Drejtori ekzekutiv i D4D, Shpend Emini, ka vlerësuar se shoqëria civile, përveçse ka qenë shumë aktive në monitorimin e procesit zgjedhor, ka kontribuar edhe në reformat e mëhershme zgjedhore. Sipas tij, vonesa për krijimin e institucioneve tregon nevojën për një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse.

Ndërsa përfaqësuesja e Ambasadës së Zvicrës në Prishtinë, Anita Schulchter Roth, ka thënë se një proces zgjedhor kredibil është i rëndë-

paga të dinjitetshme. Në këtë kontekst, ministri Ismaili ka vlerësuar se nuk do të ketë reformë të plotë në shëndetësi pa rritjen e pagave për mjekët. "Nuk do të ketë reformë të plotë në shëndetësi pa rritjen e pagave për mjekët. Ky ka qenë angazhimi im prej fillimit të mandatit. Projektligji i votuar ditë parë në Qeveri dhe i proceduar në Kuvend, siguron rritjen e pagave

si asnjëherë më parë për mjekët tanë. Kërkoj që ky projektligj, me disa ndryshime të vogla, të mbështetet dhe të votohet pa u vonuar, në mënyrë që mjekët tanë të gëzojnë sa më parë paga të dinjitetshme", ka deklaruar Ismaili në tryezën e organizuar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë, ku kanë marrë pjesë edhe deputetë dhe anëtarë të Komisionit për Shëndetësi.



## Ismaili: S'do të ketë reformë në shëndetësi pa rritjen e pagave për mjekët

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, të martën ka bërë me dije se Projektligji i votuar ditë parë në Qeveri dhe i proceduar në Kuvend, do ta sigurojë rritjen e pagave si asnjëherë më parë për mjekët. Prandaj ai ka kërkuar që ky projektligj, me disa ndryshime të vogla, të mbështetet dhe të votohet pa u vonuar, në mënyrë që mjekët të gëzojnë sa më parë



Flet për "Epokën e re", Korab Sejdiu

# Protesta, e vetmja rrugë për

Deputeti i pavarur në Kuvendin e Kosovës, Korab Sejdiu, ka treguar arsyen pse më 29 shtator do të jetë pjesë e protestës së thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje. Ai ka thënë se është nevojë urgjente për mobilizim qytetar kundër të keqes që ka kapluar çdo pore të shoqërisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sejdiu ka thënë se protesta ka mbetur i vetmi institucion kushtetues në dispozicion për qytetarët dhe opozitën. "Këtë protestë nuk e shoh si iniciativë të një subjekti politik, por si një mobilizim qytetar kundër të keqes", ka deklaruar Sejdiu, i cili ka treguar se është duke shtyrë përpara idenë e bashkimit opozitar dhe krijimit të një aleance të kësaj opozite me qytetarët, për ta luftuar të keqen. "Besoj se kemi afrim dhe koordinim të pozicioneve në mes të grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht LDK-së dhe LV-së, përfshirë këtu edhe mua", është shprehur deputeti Sejdiu

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Deputeti i pavarur në Kuvendin e Kosovës, Korab Sejdiu, ka deklaruar se protestat kanë mbetur i vetmi institucion kushtetues në dispozicion për qytetarët dhe opozitën kundër këtij pushteti. Ai ka bërë me dije se mekanizmat e tjerë demokratikë janë bllokuar nga armiqtë e të ardhës së këtij vendi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sejdiu ka vlerësuar se është emergjent mobilizimi qytetar kundër të keqes që, sipas tij, ka kapluar çdo pore të shoqërisë dhe ka zaptuar çdo post institucional në vend, përfshirë Presidencën, Qeverinë dhe Kuvendin. "Patjetër. I vetmi institucion kushtetues i mbetur në dispozicion për ne si qytetarë dhe opozitarë kundër të keqes mbetet protesta. Të tjerat janë të zaptuara dhe të bllokuara nga armiqtë e të ardhmes sonë", ka thënë Sejdiu.

Ai ka theksuar se vendi po rrezikohet nga një kastë e kalbur politike, e cila, sipas tij, ka zaptuar dhe zotëron të gjitha institucionet kyçe të vendit. "Prandaj, reagimi qytetar është i domosdoshëm. Jemi dëshmitarë të rrëshqitjes së Kosovës drejt të qenurit shtet diktatorial dhe duhet të veprojmë tani sa nuk është vonë. Po e shohim shtimin e cenimit serioz të Kushtetutës nga presidenti, një Qeveri dhe kastë në pushtet që po e falimentojnë dhe ndajnë shtetin, dhe "liderë" të papërgjegjshëm në pushtet që po e shkatërrojnë shtetësinë e Kosovës. Prandaj, reagimi i pavonuar qytetar është jetik për Kosovën!", është shprehur Sejdiu.

Më tej, deputeti i pavarur ka treguar se është duke shtyrë përpara idenë e bashkimit opozitar dhe krijimit të një aleance të kësaj opozite me qytetarët, për ta luftuar të keqen. Sejdiu ka thënë se ka afrim dhe koordinim të pozicioneve në mes të grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht LDK-së dhe LV-së. "Dita-ditës po shohim bashkërendim të qëllimeve të opozitës. Mirëpo natyrisht, subjektet opozitare

mund të kenë ide të ndryshme se si mund të arrihen ato qëllime të përbashkëta, dhe kjo pasuron opozitarizmin që është bërë dhe do të vazhdojë të bëhet. Koordinimet opozitare vazhdojnë të bëhen deri në arritjen e qëllimit përfundimtar, që janë zgjedhjet e parakohshme dhe krijimi i një qeverie legjitime, që ndërthen në vete shumicën e votuesve shqiptarë të Kosovës, që nuk është peng i Beogradit dhe që, mbi të gjitha, bën përpjekje maksimale që ditë më të mira të vijë për Kosovën", ka thënë Sejdiu.

**"Epoka e re": Z. Sejdiu, ju keni dalë në përkrahje të protestës në Lëvizjes Vetëvendosje e cila do të organizohet të shtunën. Pse vendoset ta përkrahnit?**

**Sejdiu:** Unë e kam bërë më se të qartë arsyen pse e kam bërë thirrjen publike për protestë paqësore. Mund t'i përmbledh shkurtimisht arsyet, që janë të shumta, në një tezë të vetme, e ajo është lindja e nevojës urgjente për mobilizim qytetar kundër të keqes që ka kapluar çdo pore të shoqërisë sonë dhe që është e orkestruar nga ata të cilët sot kanë zaptuar çdo post institucional në vend, përfshirë Presidencën, Qeverinë, Kuvendin e kështu me radhë. Pra, kam reaguar si deputet, para së gjithash si qytetar i këtij vendi, për ta parandaluar shkatërrimin e përgjithshëm të Kosovës.

**"Epoka e re": Në ftesën e juaj publike për protestë keni bërë thirrje për mbrojtjen e vendit nga shkatërrimi. Nga kush po rrezikohet ky vend?**

**Sejdiu:** Vendi është duke u rrezikuar nga një kastë e kalbur politike që, fatkeqësisht, sot ka zaptuar dhe zotëron të gjitha institucionet kyçe të vendit. Siç dhe kam theksuar më parë, dita-ditës po shtohet zaptimi i shtetit, dhe çdo institucion i rregullt shtetëror mbetet i bllokuar nga kjo kastë e kriminalizuar politike e dirigjuar nga Beogradi. Prandaj, reagimi qytetar është i domosdoshëm. Jemi dëshmitarë të rrëshqitjes së Kosovës drejt të qenurit shtet diktatorial dhe duhet të veprojmë

tani sa nuk është vonë. Po e shohim shtimin e cenimit serioz të Kushtetutës nga presidenti, një Qeveri dhe kastë në pushtet që po e falimentojnë dhe ndajnë shtetin, dhe "liderë" të papërgjegjshëm në pushtet që po e shkatërrojnë shtetësinë e Kosovës. Prandaj, reagimi i pavonuar qytetar është jetik për Kosovën!

**"Epoka e re": Besoni se dialogu me Serbinë dhe kjo Qeveri mund të ndalen me protesta?**

**Sejdiu:** Patjetër. I vetmi institucion kushtetues i mbetur në dispozicion për ne si qytetarë dhe opozitarë kundër të keqes mbetet protesta. Të tjerat janë të zaptuara dhe të bllokuara nga armiqtë e të ardhmes sonë.

**"Epoka e re": Përkrahja e protestës së LV-së, a do të thotë se ju po ofroheni me këtë subjekt politik?**

**Sejdiu:** Në fakt, nëse ju kujtohet, unë kam thirrur kohë më parë për protesta, edhe para se të bëjë thirrje LV-ja. Dhe këtë protestë nuk e shoh si iniciativë të një subjekti politik, por si një mobilizim qytetar kundër të keqes. Ne të gjithë jemi të obliguar t'i dalim në mbështetje çdo nisme të njerëzve të vullnetit të mirë kundër këtij skenari të kobshëm, përfshirë edhe këtë protestë. Sa i përket afrimit, unë jam duke shtyrë përpara idenë e bashkimit opozitar dhe krijimin e një aleance të kësaj opozite me qytetarët, për ta luftuar të keqen. Në atë aspekt, besoj se kemi afrim dhe koordinim të pozicioneve në mes të grupeve parlamentare opozitare, veçanërisht LDK-së dhe LV-së, përfshirë këtu edhe mua.

**"Epoka e re": Po ashtu, keni marrë pjesë në takim të lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka zhvilluar me grupin parlamentar të këtij subjekti politik. Vazhdoni të jeni deputet i pavarur apo dëshironi t'i bashkoheni ndonjë grupi parlamentar?**

**Sejdiu:** Që nga koha e fushatës parazgjedhore kam qenë pjesë, fillimisht e koalicionit parazgjedhor, pastaj pjesë e grupit parlamentar që buroi nga ai koalicion, pra atij të LDK-së. Edhe pse rrethanat e



krijua pas zgjedhjeve më kanë shtyrë që në aspekt të përkatësisë politike të jem i pavarur, punën time në Kuvend e kryej që nga marrja e mandatit si pjesë e grupit parlamentar të LDK-së, dhe kam bashkëpunim të shkëlqyeshëm me kolegët e grupit në këtë drejtim. Unë marrë pjesë në të gjitha takimet e grupit tonë parlamentar, përfshirë edhe atë të thirrur dje nga kryetari i LDK-së, akademiku Isa Mustafa. Prandaj, nuk bëhet fjalë për bashkim në ndonjë grup parlamentar, por vazhdim të aktivitetit brenda grupit parlamentar ku kam qenë që nga fillimi.

**"Epoka e re": LDK-ja, si subjekti më i madh opozitar, ka dalë kundër protestës, duke pretenduar se këtë qeveri mund të rrezo-**

**jë me mocion mosbesimi. Si duhet të veprojnë opozita për ta çuar vendin në zgjedhje të reja?**

**Sejdiu:** Dita-ditës po shohim bashkërendim të qëllimeve të opozitës. Mirëpo, natyrisht, subjektet opozitare mund të kenë ide të ndryshme se si mund të arrihen ato qëllime të përbashkëta, dhe kjo pasuron opozitarizmin që është bërë dhe do të vazhdojë të bëhet. Koordinimet opozitare vazhdojnë të bëhen derisa të arrihet qëllimi përfundimtar, që janë zgjedhjet e parakohshme dhe krijimi i një qeverie legjitime, që ndërthen në vete shumicën e votuesve shqiptarë të Kosovës, që nuk është peng i Beogradit dhe që, para së gjithash, bën përpjekje maksimale që ditë më të mira të vijë për Kosovën.

# ta kundërshtuar pushtetin



## Ministrja Hoxha kërkon përkrahjen e Polonisë për liberalizimin e vizave

PRISHTINE, 25 SHTATOR (ER) - Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka pritur të martën në takim, një delegacion të lartë të Polonisë, i prirë nga zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Szymon Szynkowski vel Sek. Pjesë e delegacionit nga Polonia ishte Anna Skiba, sekretare e Departamentit për Çështje Evropiane në MPJ, si dhe e ngarkuara me punë në Ambasadën e Polonisë në Maqedoni, Weronika Staniec-Porczyk. Ministrja Hoxha në takim ka

theksuar rëndësinë e marrëdhënieve bilaterale me Poloninë dhe rëndësinë që ka mbështetja e Polonisë për procesin e integritimit në përgjithësi. Me theks të veçantë, ministrja Hoxha ka kërkuar nga zyrtarët polakë mbështetje për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Ministrja Hoxha ka ritheksuar përkushtimin institucional të Kosovës që nga marrja e udhërrëfyesit duke përmbyshur të gjitha 95 kushtet për liberalizim, po ashtu vuri në dukje gatishmërinë institucionale për mbarëvajtjen e

procesit të liberalizimit. "Qytetarët e Kosovës janë të vetmit të privuar nga lëvizja e lirë dhe kjo përbën edhe të metë për fusha të rëndësishme për procesin integruar. Ne jemi të përkushtuar që gjithë procesi të rikonfirmojë të arriturat në vendin tonë, por edhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare", ka thënë ministrja Hoxha, duke shtuar se fushata për liberalizim është duke vazhduar dhe qytetarët po informohen për të drejtat dhe obligimet që vijnë me liberalizimin e vizave.



Zëvendësministri polak Szymon Szynkowski vel Sek ka theksuar rëndësinë që ka rruga integruar

për Kosovën dhe ka shprehur mbështetjen e Polonisë për procesin e integritimit të Kosovës.



## BIK-u i shpall zgjedhjet për Kuvend dhe për myfti

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Kryesia e Bashkërisë Islame të Kosovës (BIK), bazuar në kompetencat e veta, ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Bashkërisë Islame të Kosovës dhe për kryetar të Kryesisë së BIK-ut (Myfti) për periudhën e ardhshme pesëvjeçare (2018-2023). Përmes një komunikate për medie BIK-u ka njoftuar se zgjedhjet për anëtar të

Kuvendit të BIK-ut dhe propozimet për myfti do të mbahen gjatë muajit tetor 2018. "Zgjedhjet do të mbikëqyren nga Komisioni Kryesor i Zgjedhjeve që e emëroi Kryesia. Në këtë mbledhje Kryesia e BIK-ut, pas shqyrtimit të rezultateve të konkursit për dekan të FSI-së, ka emëruar edhe për një mandat prof. dr. Farush Rexhepin dekan të FSI-së. Në këtë mbledhje, Kryesia e

BIK-ut, pas shqyrtimit dhe analizimit, ka miratuar edhe raportin për organizimin e Haxhit 2018 si dhe raportin për aksionin e grumbullimit, therjes dhe shpërndarjes së mishit të kurbanëve. Po ashtu, kryesia, konform kompetencave të veta, ka shqyrtuar dhe vendosur për një sërë lëndësh të arritura në Kryesi ndërmjet dy mbledhjeve", është thënë në komunikatën për medie të BIK-ut.



## Limaj: Dialogu të kulmojë me njohje reciproke

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka pritur të martën në një takim njohës ambasadorin e re të Suedisë në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny. Gjatë takimit Limaj e ka njoftuar diplomatën suedeze për qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në raport me dialogun Kosovë - Serbi. Në këtë kontekst, Limaj ka thënë se dialogu është i paalternativë. "Është në interesin e dy vendeve që në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi të arrihet ujdia për mbylljen e temave të hapura dhe ky proces të kulmojë me njohjen reciproke mes dy vendeve. E falënderova ambasadorin për ndihmën e vazhdueshme që shteti mik suedez po i jep Kosovës duke e ftuar për thëllim të bashkëpunimit në të gjitha fushat mes dy vendeve", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Kurti e Selimi takohen me drejtuesit e veteranëve të UÇK-së



PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Një delegacion i Lëvizjes Vetëvendosje, i prirë nga kryetari Albin Kurti, deputeti Rexhep Selimi dhe anëtarë të Kryesisë, Ajet Potera, kanë vizituar të martën Organizatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, ku janë pritur në takim nga kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, me bashkëpunëtorë. Në këtë takim është diskutuar rreth ngjarjeve aktuale në vend, me fokus negociatat Kosovë - Serbi, si dhe për zhvillimet e fundit në lidhje me listat e veteranëve.

Ishte konstatim i përbashkët që aspiratave të Serbisë duhet t'u kundërvihemi si shtet dhe se Serbia u ka shumë borxh shqiptarëve dhe Kosovës. Ndërsa veteranët dhe invalidët e luftës së UÇK-së janë vlerë e shoqërisë sonë, se ata kanë probleme të shumta sociale, dhe se nevojitet përgjegjësi, rregull e saktësi për trajtimin e çështjeve të tyre. Në fund të dyja palët janë marrë vesh për kontakte, komunikim dhe takime më të shpeshta në këto kohë tejet të rëndësishme për Kosovën dhe kombin tonë në përgjithësi.

## Studenti 23-vjeçar vdes duke pritur të hyjë në provim

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Një student i mjekësisë ka vdekur të martën teksa ishte duke pritur të hyjë në provim në Gjinekologji. Lajmin e ka konfirmuar drejtoresha e Gjinekologjisë, Myrvete Paçarada. Ajo ka thënë për "Kallxo.com" se studenti kishte

ardhur për të hyrë në provim në Gjinekologji. "E kanë përfunduar pjesën praktike të provimit. Ka pasur të hyjë tek unë në provim, për pjesën teorike, por nuk e ka arritur", ka thënë Paçarada. Ajo ka thënë se gjendja e tij është përkeqësuar në fakultet, pastaj e kanë dërguar

në QKUK për trajtim ku dhe ka ndërruar jetë. Sipas Paçaradës, studentit 23-vjeçar i është përkeqësuar gjendja pas problemeve me enët e gjakut. "Studenti ka vdekur në Klinikën e Kardiologjisë pas 10 orë trajtim nga mjekët", ka thënë Myrvete Paçarada.





# Ministri Tahiri: 'Drejtësia 2020' do t'u japë fund lëndëve të vjetra



Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, në një konferencë për media të martën, kanë prezantuar agjendën e përbashkët "Drejtësia 2020". Me këtë rast, ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se "Drejtësia 2020" është përpjekja më serioze e institucioneve tona për ta fuqizuar sundimin e ligjit në të gjithë dimensionin e tij

më serioze e institucioneve tona për ta fuqizuar sundimin e ligjit në të gjithë dimensionin e tij. Ai ka thënë se përmes kësaj agjende institucionet tona do të koordinohen ngushtë që ta plotësojnë secilin obligim për të siguruar një sistem efikas të drejtësisë. "Drejtësia 2020" do t'u japë fund lëndëve të vjetra, do t'i japë fund papërgjegjësive së sistemit kudo që ai shfaqet, do t'i plotësojë deri në fund të gjitha kapacitetet njerëzore që janë të nevojshme brenda sistemit, do të mundësojë një profilizim të qartë dhe të besueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, do t'i risjellë fuqishëm edhe mekanizmat e zgjidhjes alternative të kontesteve si dhe do ta realizojë transparencën e plotë të sistemit të drejtësisë në të gjitha hallkat. Viti 2020 do ta gjejë sistemin e drejtë-

sisë si sistem efikas, llogaridhënës dhe i përgjegjshëm, besimi i qytetarëve ndaj të cilit do të rrjedhë ekskluzivisht nga performanca e mirëfilltë e tij", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka shtuar se institucionet e vendit nuk do të rrinë indiferente për asnjë moment dhe nuk do të lejojnë që qytetarët të presin me vite të tëra për përfundimin e një procesi gjyqësor. "Nuk do të rrimë indiferentë dhe t'i shohim bizneset tona që falimentojnë duke pritur përfundimin e rasteve gjyqësore. Nuk do të rrimë indiferentë para adresimit të përgjegjësive kudo që është e nevojshme. 'Drejtësia 2020' është përpjekja më serioze e institucioneve vendore për ta përmbyllur me sukses të plotë kapitullin e tranzicionit të gjatë dhe për ta forcuar shtetin ligjor aty ku e ka përcaktuar

Kushtetuta, ku e kanë përcaktuar vlerat e demokracisë dhe ku e presin qytetarët tanë", ka theksuar ministri Tahiri.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nehat Idrizi, ka theksuar se institucionet janë më të suksesshme, më efikase dhe më të dobishme kur veprojnë në mënyrë të bashkërenduar. Ndërkaq kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Blerim Isufaj, ka thënë se agjenda e përbashkët tregon përkushtimin për fuqizimin e sundimit të ligjit.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, për të cilën kjo ngjarje ishte paraqitja e tij e fundit zyrtare, ka theksuar se "Drejtësia 2020" nuk është obligim ligjor, por është e bazuar në dëshirën e sinqertë për ta përmirësuar sundimin e ligjit, për t'i pëmbushur kërkesat e qytetarëve të Kosovës.

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ministria e Drejtësisë, së bashku me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, me mbështetjen e plotë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasadës së ShBA-së dhe

Britanisë së Madhe, ka lansuar të martën "Drejtësinë 2020", një agjendë kjo e orientuar drejt zbatimit të masave afatshkurta përmes të cilave do të rritet efikasiteti i të gjitha hallkave të sistemit të drejtësisë.

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se "Drejtësia 2020" është përpjekja

## Mustafa dhe Kurti: Kosova ka nevojë për qeverisje të re

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka pritur të martën në shtëpinë e vet kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, me të cilin kanë biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në mes të këtyre dy partive opozitare. Mustafa nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se me Kurtin kanë vlerësuar se Kosova ka nevojë për ndryshime. "U takuam me z. Albin Kurti, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje. Biseduam për shumë tema që e rëndojnë aktualitetin në Kosovë. Shprehëm gatishmërinë ta shtojmë bashkëpunimin opozitar në

mënyrë që degradimi i qeverisjes dhe rrezikimi i territorit të ndalen sa më shpejt. Vlerësuam bashkërisht se Kosova, si kurrë më parë, ka nevojë për ndryshime", ka shkruar Mustafa.

Edhe kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka shkruar se Kosova ka nevojë urgjente për qeverisje të re. "Të gatshëm ta koordinojmë bashkëpunimin opozitar në mënyrë që degradimi i qeverisjes dhe rrezikimi i territorit të ndalen sa më shpejt. Kosova, si kurrë më parë, ka nevojë urgjente për qeverisje të re dhe cilësore", ka shkruar Kurti.





## BQK-ja dhe Banka Botërore rrisin bashkëpunimin

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën në takim menaxherin e Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni, Marco Mantovanelli, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në sistemin financiar dhe angazhimin e BQK-së për ta mbështetur zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Guvernatori Mehmeti ka njoftuar Mantovanellin rreth rritjes së aktivitetit të sistemit financiar në mbështetje të zhvillimit

të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, si dhe e ka falënderuar për mbështetjen e pa kursyer që Banka Botërore ia ka dhënë BQK-së në shumë projekte të rëndësishme. Ndërsa menaxheri i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni, Marco Mantovanelli, ka falënderuar guvernatorin Mehmeti për bashkëpunimin e deritanishëm, duke shprehur gatishmërinë që bashkëpunimi me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të vazhdojë të rritet.



## 'KRU Prishtina': Kush ka dy fatura të papaguara do të mbetet pa ujë



PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Aksioni për shkyçjen individuale të konsumatorëve borxhlinj nga shërbimet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit është duke vazhduar me intensitet të lartë në qytete dhe fshatra, me theks të veçantë në Prishtinë.

Në një komunikatë për media, "KRU Prishtina" ka njoftuar se aksioni ka filluar në janar të këtij viti dhe do të vazhdojë deri në

fund të këtij viti. Sipas "KRU Prishtina", me shkyçje po përballët secili konsumator që ka dy e më shumë fatura të papaguara ndaj shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. "KRU Prishtina" u ka bërë thirrje konsumatorëve t'i kryejnë pagesat me rregull dhe t'u shmangen ndëshkimeve të kompanisë, ndërkohë që konsumatorëve që kanë përfituar nga Ligji për faljen e borxheve publike u ka

bërë thirrje t'i respektojnë kontratat për riprogramimin e borxhit. "Duke filluar nga data 1 shkurt 2018, të gjithë konsumatorët që kanë përfituar nga Ligji për faljen e borxheve publike dhe nuk i janë përmbajtur kontratës për pagesën me këste të borxhit të riprogramuar do t'u rikthehet borxhi i falur, bazuar në Ligjin për faljen e borxheve publike", është theksuar në komunikatën e "KRU Prishtina".

## 'Oportuna' Studentore: Qëllimi ynë, të jemi më pranë të rinjve me ide kreative

PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Organizata "Oportuna" Studentore (OST) është organizatë joqeveritare e cila është themeluar në mars të vitit 2016, me qëllim të krijimit dhe zhvillimit të mundësive të reja për studentët në nevojë. Kësaj organizate i ka dhënë përkrahje drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës, Januz Salihaj, i cili ka treguar se përkrahja do të jetë në zhvillimin e dy programeve të suksesshme me fëmijë në institucionet parashkollore dhe shkollore të Komunës së Prishtinës, si aktivitetet të lira jashtëkurrikulare, duke parë rëndësinë e tyre në aspektin e integritetit të grupmoshave të reja në aktivitete inovative zhvillimore. Sipas një njoftimi për medie, falë këtyre programeve organizata "Oportuna" Studentore ka arritur të grumbullojë fonde të mjaftueshme për rregullimin e qendrës së tyre në Prishtinë. "Tani ofrojnë trajnime të ndryshme për studentë dhe të rinj të Prishtinës, duke i ndihmuar ata nga ana sociale -

financiare dhe intelektuale, duke i trajnuar ata për subjekte administrative të ndryshme. Njëherësh organizata OST ka filluar të krijojë hapësira punuese për studentë në zhvillim dhe fuqizim të rinisë duke promovuar punën dhe idetë e tyre kreative", është thënë në njoftimin e Organizatës "Oportuna" Studentore. Drejtori i kësaj organizate, Qëndrim Lluka, ka vlerësuar përkrahjen e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës si një mundësi jo vetëm për OJQ-në "OST", por për të gjithë të rinjtë dhe studentët e Prishtinës, ku tani e kanë një portë të hapur për t'u inkuadruar në programe të ndryshme të zhvillimit, si në bazë të këshillimeve për karrierë, gjithashtu edhe në inkuadrim në programe të shkëmbimit dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Ai ka shtuar se Komuna e Prishtinës është shumë e hapur ndaj programeve inovative të zhvillimit, ku shihet qartë përkushtimi dhe serioziteti për rritjen e



standardit të punës dhe shtyrjes së rinisë së Kosovës drejt progresit. "Gjithashtu, puna e z. Salihaj, drejtorit të Arsimit në Komunën e Prishtinës, është

një shembull konkret për mbështetje", ka thënë ai. Drejtori i organizatës "OST" së bashku me stafin e tij i kanë ndarë mirënjohje drejtorit të

Arsimit në Komunën e Prishtinës, Jonuz Salihaj, duke vlerësuar kontributin e tij për fuqizimin dhe zhvillimin e rinisë.



# Nuk kalon në parim Projektligji për mbrojtjen e ajrit në Komisionin për Bujqësi

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur të martën, nën udhëheqjen e kryetarit Muharrem Nitaj, ka shqyrtuar Projektligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, por ky projektligj në parim nuk ka kaluar për shkak të kundërshtimeve që kishte nga anëtarët e këtij komisioni



**EPOKA  
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

Prishtinë, 25 shtator - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar të martën Projektligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Ky projektligj nuk ka kaluar në parim për shkak të kundërshtimeve që kishte nga anëtarët e këtij komisioni, me arsyetimin se "agjenda ishte e ngarkuar dhe nuk kanë arritur të konsultohen me ekspertët dhe materialin gjegjës".

Në këtë mbledhje, komisioni ka formuar grupin punues për këtë projektligj, i cili do të kryesohet nga anëtari Salih Salihu.

Ndërkaq deputetët e LDK-së, Besa Gaxheri dhe Lutfi Zharku, refuzuan të marrin pjesë në votim, me arsyetimin se LDK-ja e ka bërë të qartë kahun e kësaj qeverisje. "LDK-ja nuk do të jetë pjesë e grupit punues, nuk jemi robër të mocionit. Ne kemi obligimet tona. LDK-ja nuk do të marrë pjesë në votim në asnjë komision", ka thënë Gaxheri. Kryesuesi i këtij komisioni, Muharrem Nitaj, ka thënë se Kosova është në fazën e hershme të implementimit të masave për mbrojtjen e ajrit. "Nga ndotja e ajrit janë të ekspozuar nga rreziku qytetarët e Kosovës, sidomos ata që jetojnë në zonat urbane. Unë apeloj që të merret pjesë në votim. Asnjëri nga ne

nuk e kemi fuqinë individuale që ta rrëzojmë apo ta mbajmë në këmbë Qeverinë", ka thënë Nitaj. Myzafete Hakaj nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ka prezantuar të dhënat e këtij projektligji. Ai ka deklaruar se ky projektligj është konform direktivave të BE-së. "Ky projektligj është konform direktivave të BE-së dhe gjatë implementimit të Ligjit të mëhershëm kishim pengesa. Ne duhet ta përshtatemi këtë projektligj konform interesave ambientale dhe ekonomike të

qytetarëve të Kosovës. Projektligji ka shtatë kapituj dhe 71 nene dhe i referohet mbrojtjes dhe cilësisë së ajrit. Ky ligj prek gjithë substancën e ligjit paraprak", është shprehur Hakaj. Ndërkaq deputetja e LDK-së, Besa Gaxheri, ka thënë se Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja është i domosdoshëm. Ajo ka uruar që të rregullohet cilësia e ajrit, duke theksuar se deputetët kanë përgjegjësi të krijojnë ligje të mira.

Deputetja e PSD-së, Sali Salihu,

ka theksuar se është urgjente të bëhet më shumë për mbrojtjen e ajrit. Si shembull sfidues ajo ka përmendur 'Kosovën B', së cilës nuk i janë ndërruar filtrat që 30 vjet. Kurse deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sali Zybaq, ka deklaruar se nuk kanë pasur kohë dhe informim të mjaftueshëm për të diskutuar lidhur me këtë projektligj. Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, në këtë mbledhje ka apeluar t'i dilet në mbrojtje Komplexit Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz.

## Reçica vizitoi një nga qendrat më të mëdha të edukimit profesional në Gjermani



PRISHTINË, 25 SHTATOR (ER) - Gjatë qëndrimit në Gjermani, ministri i Punës dhe Mirëqenies

Sociale, Skender Reçica, ka vizituar Qendrën e Edukimit dhe Trajnimit Profesional në

Traunstein të Gjermanisë, e cila është anëtare e Odës së Zëjtareve të Mynihut dhe të

Bavarisë së Epërme. Ministri u prit nga drejtori i Qendrës, Max Stadler, nga i cili u

njoftua rreth punës që bëhet në këtë qendër sa i përket edukimit dhe aftësimin profesional sipas sistemit dual gjerman, në një numër të madh profilesh.

Gjithashtu, ministri Reçica ka vizituar disa punëtorë në të cilat po aftësohen një numër i madh i të rinjve në profile të ndryshme. Reçica gjatë takimit me Stadlerin ka theksuar se Qeveria e Kosovës është duke punuar për fuqizimin e arsimit dhe aftësimin profesional, bashkë edhe me partnerët gjermanë. Ministri ka pohuar se është shumë e rëndësishme të forcohet bashkëpunimi në mes të qendrës në fjalë dhe qendrave për aftësim profesional në Kosovë, me qëllim të përfitimit të përvojave dhe avancimit të edukimit dhe trajnimit profesional.

Stadler ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim si dhe për t'i ndihmuar institucionet e edukimit dhe aftësimin dual në Kosovë.

## Dështon mbledhja e Komisionit për Financa, shkak kuorumi

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka dështuar të mba-

het të martën për shkak të mungesës së kuoromit. Në rend dite ishte shqyrtimi i raportit të punës së komisionit

për sesionin pranveror 2018 dhe diskutimi për auditimin e raporteve të deklarimit financiar të subjekteve politike për

vitin 2017. Kryetari i komisionit, Driton Selmanaj, ka thënë se ekziston interesim minimal nga deputetët për mbledhje.







## MAQEDONIA NË NATO E BE, FITORE PËR POPULLIN SHQIPTAR



**Ismet SYLEJMANI**

I dashur popull shqiptar që ke përballuar dhe shpartalluar me sukses të gjitha sulmet dhe goditjet shfarosëse dhe asimiluese që të janë vërsulur nga të gjitha anët e në të gjitha kohët,

dhe ke dalë fitimtar kurdoherë, po të ofrohet një datë e madhe, po të ofrohet 30 shtatori 2018. Kjo datë, 30 shtatori në NATO dhe BE, për shqiptarët është datë historike, është datë euroatlantike, është sikur dikur UÇK-ja që u bë kthesa e madhe e shekullit shqiptar! Pas luftës së madhe e titanike të UÇK-së, NATO-ja është ajo që ka bombarduar Serbinë dhe ushtrinë e policinë e saj për shqiptarët! Kjo datë është e madhe për shqiptarët në përgjithësi, në mënyrë të veçantë për shqiptarët

në Maqedoni!  
Kombi shqiptar në Maqedoni kurrë më parë në histori nuk ka shënuar suksese më të mëdha e më të lavdishme sesa që është duke i bërë nën udhëheqjen largpamëse e të sigurt, të udhëqësit të saj të madh e të popullit shqiptar, ilegalit, vizionarit e të vendosurit, luftëtarit të orëve të para, themeluesit të UÇK-së e kryekomandantit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, themeluesit e kryetarit të suksesshëm e historik të BDI-së, Ali Ahmeti!

Pas luftës së madhe e titanike të vitit 2001, populli shqiptar në Maqedoni është bërë zoti më i madh dhe i padiskutueshëm i fateve të veta!  
Sa ditë të mira e të mëdha ka sjellë lufta për liri e barazi, prosperitet e demokraci e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni dhe UÇK-ja në përgjithësi.  
Më 30 shtator do të mbahet referendumi dhe do të jetë votimi për Maqedoninë e re dhe hyrjen e saj në NATO dhe BE!  
Popull shqiptar, dil dhe voto për

Maqedoninë e re në NATO dhe në BE!  
Populli shqiptar për herë të parë ka mundësinë dhe detyrimin njëkohësisht, ta vulosë fatin e vet dhe të Maqedonisë, t'i përcaktojë rrugët e së ardhmes së vet euroatlantike!  
Maqedonia në NATO e BE, fitore e popullit shqiptar në Maqedoni!  
PO-ja shqiptare për në NATO dhe BE është shprehja e madhe e solidaritetit dhe miqësisë me ShBA-në dhe shtetet e tjera të fuqishme rreth saj!  
**Prishtinë, 25. 9. 2018**





## Muharremaj paralajmëron investime të mëdha të KEDS-it në Therandë

Therandë, 25 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, është takuar me drejtuesit e KEDS-it, me të cilët ka biseduar për investime të kësaj kompanie në këtë komunë. Muharremaj ka bërë me dije se në Komunën e Therandës do të ketë investime të mëdha nga KEDS-i. "Sot isha në takim me drejtorin për investime, Hasan Oz, drejtorin për bashkëpunim me institucione

qeveritare, Avni Alidema, dhe menaxherin për punë ndërtimore, Faruk Gjukaj, ku diskutuam për fazat e mëtejshme. Në qendrën e qytetit të Suharekës, Sopij, Gelanc, Doberdelan, Greikoc, Bukosh, Shirokë, Studençan etj., do të ketë investime që fillojnë këtë vit dhe do të mbarojnë vitin tjetër. I gjithë angazhimi im është i drejtuar në shërbim të qytetarëve", ka thënë Muharremaj.



## Pjesëtarët e policisë në Malishevë dhurojnë gjak vullnetarisht

Malishevë, 25 SHTATOR (ER) - Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të stacionit në Malishevë, edhe stafi civil i këtij stacioni, vullnetarisht të martën kanë dhuruar gjak për nevojat e shërbimit shëndetësor në vend. Këtij aksioni, përveç zyrtarëve policorë, i janë përgjigjur edhe disa qytetarë, ndërsa këtë aksion të dhurimit vullnetar të gjakut e ka përshëndetur edhe i

pari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka vizituar policët derisa ishin duke dhuruar gjak, njofton komuna, përcjell "Klan Kosova". Kryetari Begaj është pritur nga ushtruesi i detyrës i komandantit të Stacionit Policor në Malishevë, toger Azem Krasniqi dhe i kanë vizituar zyrtarët policorë, të cilët vullnetarisht ishin duke dhuruar gjak. Me

këtë rast, kryetari Begaj i ka përshëndetur të gjithë zyrtarët policorë të Malishevës, të cilët, krahas detyrës së tyre për ruajtjen e sigurisë, janë edhe dhurues vullnetarë të gjakut dhe përmes kësaj, edhe shpëtojnë jetë edhe në këtë mënyrë. Aksionit për dhurimin vullnetar të gjakut i janë përgjigjur edhe qytetarë të tjerë dhe zyrtarë komunalë të Malishevës.



## Qendrës së Mjekësisë Familjare në Ferizaj i dhurohet një autoambulancë e re

Ferizaj, 25 SHTATOR (ER) - Bashkatdhetari Ahmet Haliti, i cili jeton dhe punon në Gjermani, ka dhuruar një autoambulancë të re për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Ferizaj. Ai ka bërë me dije se në Gjermani punon për rregullimin e këtyre automjeteve, ndërsa me financat e tij ka blerë këtë autoambulancë e cila ka një kosto rreth 10

mijë euro. "Unë punoj që një kohë të gjatë atje, që 26 vjet. Kam krijuar lidhje të mira, prandaj më është dhënë mundësia dhe e kam sjellë veturën për vendlindjen time", ka thënë Haliti. Ndërsa drejtues të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj kanë mirëpritur autoambulancën e re, duke pasur parasysh planet për zgjerim e

modernizim të shërbimeve emergjente edhe në terren. Asllan Bajrami, ushtrues detyre i drejtorit të QKMF-së në Ferizaj, ka pohuar se tani e tutje do të jetë më lehtë qasja deri te rastet emergjente. Me ardhjen e autoambulancës së re nga Gjermania janë bërë pesë autoambulanca që mbulojnë shërbimet mjekësore në Ferizaj.

## Kryetarët e komunave diskutojnë për mundësitë e bashkëpunimit

Skenderaj, 25 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, me ftesë të ministrit të Zhvillimit Rajonal të Republikës së Kosovës, Rasim Demiri, ka marrë pjesë në takimin që është mbajtur në Prishtinë, me qëllim të diskutimit rreth aktiviteteve të agjencive zhvillimore rajonale të Kosovës, për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen, si dhe për gjetjen

e modaliteteve të financimit të qëndrueshëm. Kryetari Jashari ka thënë se Agjencitë zhvillimore rajonale të Kosovës po luajnë rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe forcimin e zhvillimit ekonomik në rajonet ku veprojnë. Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ai i Gjilanit, Lutfi Haziri, kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi etj.





## Rusia do ta furnizojë Sirinë me sistem modern raketash

MOSKË, 25 SHTATOR - Rusia njoftoi se në javët e ardhshme do të furnizojë Sirinë me një sistem modern raketash S-300. Ministri rus i Mbrojtjes Sergei Shoigu tha se presidenti Vladimir Putin urdhëroi këtë masë, pasi sistemi sirian i mbrojtjes ajrore goditi pa dashje javën e kaluar një aeroplan rus, në vend të një avioni izraelit, duke

vrarë të 15 personat që ndodheshin në bord. "Jemi të sigurt se zbatimi i masave të tilla do të qetësojë disa koka të nxehta dhe do ndalojë veprimet impulsive të atyre që paraqesin kërcënim për trupat tona, përndryshe do të duhet të reagojmë në përputhje me situatën", tha ministri Shoigu. Këshilltari amerikan për Sigurisë

Kombëtare John Bolton këshilloi Rusinë të rishqyrtojë vendimin, duke thënë se sistemi i ri i raketave do të ishte një "përshkallëzim domethënës" i tensioneve tashmë të larta në rajon.

Lidhur me incidentin Rusia ka fajësuar Izraelin, ushtria e të cilit po kryente sulme ajrore në Siri në atë kohë.



## Trumpi në OKB: Irani po mbjell kaos, vdekje dhe shkatërrim

Presidenti Donald Trump tha në OKB se ShBA-ja ka nisur një fushatë presioni ekonomik për t'i mohuar liderшипit iranian fondet e nevojitur që ta çojë përpara agjendën e tij gjakatare. "Sanksione shtesë do të nisin muajt e ardhshëm. Bota duhet të sigurohet që sponsori kryesor i terrorizmit të mos zotërojë armët më të rrezikshme që ekzistojnë", tha Trumpi

NJU JORK, 25 SHTATOR - Fjalimin e tij të shumëpritur në OKB, presidenti amerikan Donald Trump e ktheu në një sulm ndaj liderшипit iranian, duke e akuzuar se po mbjell "kaos, vdekje dhe shkatërrim" në mbarë Lindjen e Mesme. "Shtetet e Bashkuara kanë nisur një fushatë presioni ekonomik për t'i mohuar këtij regjimi fondet e nevojitur që ta çojë përpara agjendën e tij gjakatare. Sanksione shtesë do të nisin muajt e ardhshëm. Bota duhet të sigurohet që sponsori kryesor i terrorizmit të mos zotërojë armët më të rrezikshme që ekzistojnë", tha Trumpi.

Me këtë argument dhe pohimet se udhëheqësit iranianë po grabisin pasurinë e kombit të vet, presidenti amerikan justifikoi

tërheqjen nga marrëveshja bërthamore me republikën islamike, ndërsa u mburr se administrata e tij ka arritur më shumë se pothuajse "kushdo tjetër" në historinë e Amerikës.

Këto fjalë u pritën me të qeshura, por trupi iu përgjigj në të njëjtën mënyrë duke thënë: "nuk e prisja këtë lloj reagimi". Shtetet e Bashkuara, këmbënguli ai, janë sot më të forta, më të pasura dhe të sigurta. Trumpi nuk la pa kujtuar takimin historik me udhëheqësin koreano-verior Kim Jong-un, duke nënvizuar se kjo përballje çoi në zhvillime që deri përpara pak muajsh ishin të paimagjinueshme.

Raketat koreano-veriore nuk po fluturojnë me në çdo drejtim të mundshëm dhe testet nukleare



kanë reshtur, tha ai përpara Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që zhvillon punimet në Nju Jork. Një prej temave kryesore të fjalimit ishte drejta e Amerikës për të ndjekur rrugën e vet në botë, e kësaj ideje, shefi i Shtëpisë së Bardhë i mëshoi me

forcë.

"Shtetet e Bashkuara nuk do t'ju tregojnë se si të jetoni, punoni apo adhuroni, ne vetëm kërkojmë që në këmbim, ju të nderoni sovranitetin tonë", tha Trumpi.

Presidenti shtoi se ndihma amerikane për vendet e tjera po

shihet me shumë imtësi. Vetëm miqtë do ta përfitojnë ndihmën tonë, deklaroi ai, ata që na respektojnë dhe që janë dashamirës vërtet. Sa për vendet e tjera, presim të paguajnë atë që u takon në lidhje me koston e mbrojtjes.

## Kina nuk sheh nevojën e bisedimeve tregtare me ShBA-në



PEKIN, 25 SHTATOR - Kina njoftoi të martën se është e pamundur të zhvillohen bisedime tregtare me Shtetet e Bashkuara, në kushtet e vendosjes së tarifave prej Uashingtonit.

Një ditë pas hyrjes në fuqi të tarifave me vlerë prej 200 miliardë dollarësh ndaj mallra kineze, zëvendësministri i tregtisë Wang Shouwen tha se Pekini është i hapur për

negociata, nëse të dyja palët trajtojnë njëra-tjetrën në mënyrë të barabartë dhe me respekt. "Tashmë që Shtetet e Bashkuara kanë miratuar këto lloj kufizimesh në shkallë të gjerë është si t'i vendosësh dikujt thikën në fytyrë. Si mund t'i vazhdojmë bisedimet nën këto rrethana?!", tha ia.

Wang u takua me zyrtarët amerikanë në Uashington më

muajin gusht, pas muajsh të tërë mungese takimesh të nivelit të lartë mes dy ekonomive kryesore në botë. Sekretari amerikan i Tësarit Steven Mnuchin i pati ftuar zyrtarët kinezë për bisedime të reja, por tarifat e reja të presidentit Trump dhe paralajmërimet për një raund të ri prej 267 miliardë dollarësh, duket se i kanë fundosur këto përpjekje.

## Papa: Skandalet seksuale po largojnë njerëzit nga Kisha

VATIKAN, 25 SHTATOR - Papa Françesku e ka pranuar se skandalet seksuale që po godasin Kishën Katolike, po zemërojnë njerëzit dhe po i largojnë ata nga Kisha dhe se, sipas tij, Kisha duhet të ndryshojë nëse dëshiron të mbajë afër generatën e

ardhshme. Papa iu referua kështu krizës që tronditi papatin e tij, gjatë ditës së fundit të vizitës në vendet baltike. Kjo ngjarje përkoji me publikimin e një raporti të ri që bën fjalë për abuzime seksuale gjatë disa dekadave në kishat

katolike në Gjermani.

Papa iu tha të rinjve në Estoni, vend ky që konsiderohet si më së paku religjioz në botë, se e di që shumë të rinj ndjehen se Kisha nuk ka asgjë për t'iu ofruar dhe se thjeshtë nuk i kupton problemet e tyre të kohës së

sotme. "Për të qëndruar pranë jush ne e dimë se duhet të ndryshojmë shumë situatën të cilat iu largojnë", ka thënë Papa Françesku. Ai ka thënë se Kisha Katolike dëshiron të flasë hapur për gjitha akuzat në drejtim të saj.





Promovohet libri monografik "Djaloshi me shikim lirie - Ahmet Alush Pantina", kushtuar dëshmorit Ahmet Pantina

## Përjetësohet vepra e dëshmorit Ahmet Alush Pantina

Me rastin e 20-vjetorit të rënies heroike të dëshmorit të kombit Ahmet Alush Pantina të martën në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës është promovuar libri monografik kushtuar këtij dëshmorit "Djaloshi me shikim lirie - Ahmet Alush Pantina". Në promovimin e këtij libri u tha se vepra e Ahmet Alush Pantinës është ende e freskët dhe do të mbetet frymëzim i përhershëm për brezat që vijnë



Pantinës është ende e freskët dhe mbetet frymëzim i përhershëm për ne dhe brezat që vijnë. Ky

përvjetor është një përpjekje modeste për ta shënuar, riafirmuar e hedhur dritë mbi jetën e këtij kolosi të qëndresës sonë shqiptare. Sot historiografia shqiptare po begatohet edhe me këtë vepër dhe botim të veçantë", ka thënë Sylja.

Recensenti i këtij libri, Nuri Behxheti, ka vlerësuar lart vlerën e librit. "Lufta e fundit është më e madhja dhe më e suksesshmja. Ky libër është i vogël për ta përfshirë jetën e heroit Pantina", ka thënë ai.

Recensenti tjetër, Ibrahim Gashi, e ka përshkruar jetën dhe veprën e dëshmorit Ahmet Pantina. Ai ka thënë se ky libër përmban 14 kapituj, ku përshkruhet vepra dhe jeta e dëshmorit të kombit, Ahmet Alush Pantina. Ndërkaq

edhe Sali Bashota, recensenti i librit, ka thënë se kjo vepër portretizon dëshmorin Ahmet Pantina me heroizmin dhe luftën e UÇK-së. "Veprimtaria e 19-vjeçarit Ahmet Pantina ishte heroike", ka thënë ai.

Ndërsa autori i librit, Jusuf Osmani, ka thënë se është munduar që me fakte ta paraqesë jetën dhe veprën e dëshmorit Ahmet Pantina.


Në emër të familjes ka folur vëllai i dëshmorit, Xhevdet Pantina, i cili ka falënderuar autorin dhe panelin e profesorëve dhe të pranishmit për pjesëmarrje. I pranishëm në promovimin e këtij libri ishin edhe deputetët të Kuvendit të Kosovës, si dhe kryetari i Luginës së Preshevës, Shqipërim Arifi.

**EPOKA E RE** **Arbisa SHEFKIU**

**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Me rastin e 20-vjetorit të rënies heroike të dëshmorit të kombit Ahmet Alush Pantina të martën janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve te Kodra e Kuqe në Grabanicë të Klinës, në orën 10:30 janë mbajtur homazhe te lapidari i dëshmorit në fshatin Llozicë, kurse në orën 12:00 është promovuar libri monografik

"Djaloshi me shikim lirie - Ahmet Alush Pantina", i autorit Jusuf Osmani, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

Kryeredaktori dhe drejtori i Institutit të Historisë, Sabit Sylja, ka thënë se historiografia shqiptare po begatohet edhe me këtë vepër. Ai ka thënë se ishin armët e UÇK-së të cilat e hoqën maskën gjenocidale të Beogradit, duke theksuar se Ahmet Pantina me rënien e tij ishte frymëzim për ne. "Vepra e Ahmet Alush



## Promovohet libri monografik 'Agimi i lirisë'

**EPOKA E RE** **Arbisa SHEFKIU**

**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Me rastin e 20-vjetorit të vdekjes së dëshmorit të kombit të zonës së Shalës së Bajgores, Agim Rrahim Ramadani, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës të martën është bërë promovimi i librit monografik "Agimi i lirisë" i autorit Bedri Tahiri.

Redaktori i këtij libri, At dhe Hykolli, ka thënë se në librin "Agimi i lirisë" autori e ka përshkruar Agimin si një lirisdashës dhe lirisdashës pasi, sipas tij, ka bërë shumë për lirinë e vendit. "Autori e nis me një thënie në pjesë hyrëse

ku thuhet se historia e botës është vetëm biografia e njerëzve të mëdhenj, që në mesin e të mëdhenjve është edhe Agim Ramadani, i cili nuk ka kursyer asgjë për ta sjellë lirinë e popullit. Ai ishte pjesë e çdo manifestimi që kishte të bënte me kauzën kombëtare si në grevat e minatorëve, po ashtu edhe në Lëvizjen Popullore që atë botë shqiptarët bënin përpjekje për t'i luftuar padrejtësitë serbe", ka thënë Hykolli.

Ndërsa recensenti i librit monografik "Agimi i lirisë", Sabahajdin Cena, ka thënë se kjo vepër arrin ta kënaqë kureshtjen e çdo lexuesi. "Si recensenti i librit jam i



mendimit se vepra e sapodalë në dritë, e pajisur me një aparatshkencore në frymën e neopozitivizmit historik, arrin ta kënaqë

kureshtjen e çdo lexuesi, por edhe objektivat e shkencëtarëve që merren me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj së cilës

kohët e fundit po ngritën shumë mjegullina", është shprehur Cena. Ndërsa autori i librit "Agimi i lirisë", Bedri Tahiri, ka thënë se këtë libër e ka shkruar falë ditarit të dëshmorit. "Libri që sot po e përurojmë, në fakt ka disa autorë, unë jam vetëm një prej tyre. Atë e shkroi në rend të parë, trimi i lirisë, Agimi, me gjakun e vet, duke na i lënë edhe dy ditarë të shkëlqyer, të cilët së shpejti do ta shohin dritën", ka thënë Tahiri.

Krejt në fund vëllai i dëshmorit, Agim Rrahim Ramadani, Fehmiu, në emër të familjes ka falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen në promovimin e librit "Agimi i lirisë".

## Në Kosovë për herë të parë publikohet "Fjalori enciklopedik"

**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Në Kosovë është botuar për herë të parë një fjalor enciklopedik. Ky është projekti më i madh dhe më i rëndësishëm i Akademisë së Shkencave dhe

të Arteve të Kosovës. Fjalori ndahet në dy vëllime: "Fjalori enciklopedik i Kosovës, I, A-K" dhe "Fjalori enciklopedik i Kosovës, II, L-Zh. Janë gjithsejtë 1 818 faqe, në të

cilat janë përfshirë tekstet e rreth 6 000 zërave, të hartuar nga 506 autorë, një vepër kolektive e hartuar nga profesorë universiteti, shkrimtarë, publicistë, artistë dhe

ekspertë të fushave të ndryshme të shkencës dhe të dijes. Botimi do të shpërndahet në të gjitha institucionet qendrore të Kosovës, në bibliote-

ka dhe redaksitë e mediave, në mënyrë që informacioni dhe të dhënat në përdorim për Kosovën dhe botën shqiptare të dalin më të plota dhe të sakta.



**E rrallë**

## Mbi 1 600 zogj marrin pjesë në konkursin e këndimit të shpendëve

Konkursi vjetor i këndimit të shpendëve në Tajlandë tërhoqi mijëra spektatorë nga Azia juglindore. Mbi 1 600 zogj nga Tajlanda, Malajzia dhe Singapori morën pjesë në konkursin duke sjellë zogjtë e tyre që



këndonin kundër të tjerëve. Kafazet e zogjve vendosen në lartësinë tri metra mbi tokë të mbajtura në një shufër metalike.

**FOTO E DITES**



Shkuma e mbledhur në lumin e ndotur Yamuna në Nju Delhi të Indisë. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## 'Zbulimi i dekadës', gjendet anija 400-vjeçare në det

Arkeologët kanë gjetur një anije 400-vjeçare në brigjet e Portugalisë. Gjetja e kësaj anije u konsiderua nga një specialist si "zbulimi i dekadës". Anija e mbytur u zbulua në Cascais, pranë kryeqytetit Lisbonë dhe mbante stemën e Portugalisë. Ekipi i shkencëtarëve beson se anija



po kthehej nga India kur u mbyt diku midis viteve 1575 dhe 1625. Ngjarja ndodhi në kulmin e tregtisë së erëzave mes Portugalisë dhe Azisë.

## BARSOLETA E DITËS



**Gruaja:** Çka po më blen për ditëlindje?  
**Burri:** Vitin e ardhshëm do të t'i blej një palë vathë.  
**Gruaja:** E këtë vit?  
**Burri:** Këtë vit po t'i shpoj veshët.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

## "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

## "THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

## "THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 orë 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black




**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**  
Mos kini frikë të thoni hapur mendimin tuaj sot. Edhe pse nuk do të keni përkrahje, ajo që mendoni është e drejtë.



**DEMI**  
Nëse nuk keni marrë një vendim të qartë sa i përket karrierës duhet të filloni t'i bëni ndarjet tuaja dhe t'i përcaktoni prioritetet.



**BINJAKËT**  
Nuk duhet t'i lejoni frikësimet e tuaja të brendshme t'ju frenojnë për të marrë vendime që në fund të ditës janë në të mirë të punës.



**GAFORRJA**  
Edhe pse nuk doni të ndryshoni gjë nga rutina juaj e përditshme po e kuptoni që shumë gjëra po ju ndalin dhe po ju pengojnë.



**LUANI**  
Problemi juaj më i madh sot është përqendrimi. Nuk do të mund të përqendrohemi për asnjë çast.



**VIRGJËRËSHA**  
Sot për një kapriçio tuajën do të mund të rrezikoni një projekt shumë të rëndësishëm. Do të rregulloni gjithçka në fund.



**PESHORJA**  
Nuk ju pëlqen të merrni vendime që nuk kanë asnjë pasojë për ju. Doni ose gjithçka ose asgjë.



**AKREPI**  
Mos kini drojë të vini në pikëpyetje impenjimet që keni për sot. Nëse do ta bëni do të jetë për një arsye të mirë.



**SHIGJETARI**  
Gjithmonë keni qenë aventurieri dhe kjo ju ka sjellë veç gjëra të mira. E rëndësishme është të mos sakrifikoni shumë.



**BRICJAPI**  
Duhet të hiqni dorë nga persona që kanë përfitur gjithmonë prej jush. Është mirë të jeni të vetëdijshëm për aftësitë tuaja.



**UJORI**  
Rruga që po përshkoni ka shumë pengesa dhe ju e dini këtë gjë. Nuk doni të bëni kompromise për çështje të caktuara.



**PESHQIT**  
Duhet të jeni sa më konstruktive në raportet e reja që keni ndërmarrë së fundmi. Nga ana profesionale çdo gjë është në një linjë të re.



## Drake kërkon falje pasi anuloi dy koncerte në Miami



**D**rake i anuloi dy koncerte në Miami këtë fundjavë. Ai bëri një postim në "Instagram" për fansat duke u kërkuar falje dhe duke shpjeguar se ai ka qenë i sëmurë. "Dua vetëm të

them se sa keq më vjen. Unë u sëmura shumë shpejt dhe kurrë nuk kam përjetuar diçka të tillë në jetën time. Faleminderit dy mjekësve dhe infermiereve që më ndihmuan", ka shkruar Drake.



## Demi Lovato shfaqet pas rehabilitimit

**D**emi Lovato është paraqitur për herë të parë pas një mbidoze fatale që pati gjatë verës. Këngëtarja 26-vjeçare u pa duke biseduar me një grua derisa po pinte një kafe pranë objektit të saj të rehabilitimit,

shkruan "DailyMail". Është raportuar javën e kaluar se Demi ishte transferuar nga një qendër rehabilitimi në Bregun Lindor në një tjetër institucion që është i njohur botërisht për programet e tij të varësisë.

## David Beckham ndryshon ngjyrën e flokëve



**L**egjenda e futbollit, David Beckham, i njohur për stilin e veçantë të dukjes, këtë herë ka befasuar fansat me ndryshimin e ngjyrës së flokëve. Biondi 43-vjeçar gjatë pushimeve në Miami ka

vendosur t'i bëjë flokët e tij të duken ngjyrë kafe, shkruan "DailyMail". Së fundmi ai u shfaq tejet elegant në Hong Kong të Kinës me kostum të zi që e kishte kombinuar me një kravatë me pika.

## Demi Lovato shfaqet pas rehabilitimit



**D**emi Lovato është paraqitur për herë të parë pas një mbidoze fatale që pati gjatë verës. Këngëtarja 26-vjeçare u pa duke biseduar me një grua derisa po pinte një kafe pranë objektit të saj të rehabilitimit,

shkruan "DailyMail". Është raportuar javën e kaluar se Demi ishte transferuar nga një qendër rehabilitimi në Bregun Lindor në një tjetër institucion që është i njohur botërisht për programet e tij të varësisë.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

TOTTENHAM - WATFORD

1

WEST HAM - MACCLESFIELD

1&amp;3+

ATHLETIC BILBAO - VILLARREAL

GG

# Adam Roczek: Do ta ndihmojmë zhvillimin e sportit të Kosovës

"Vizita ime në Kosovë nuk është vetëm vizitë formale. Do të kemi këtu një punëtori në mënyrë që të ndihmojmë dhe të këshillojmë si ta zhvillojmë sportin në universitetet e Kosovës për përfitimet e studentëve, për të mirën e shoqërisë në Kosovë", ka thënë Adam Roczek



**PRISHTINË, 25 SHTATOR** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim presidentin e Federatës Evropiane të Sportit Universitar, Adam Roczek. Ministri Gashi ka thënë se vizita e presidentit Adam është pikërisht në kuadër të shënimit të Javës Evropiane të Sportit dhe ka për qëllim për t'i parë nga afër të arriturat si shtet në infrastrukturën sportive. "Është fat i mirë që Kosova ka Federatën e Sporteve Universitare. Dhe ne si ministri jemi duke i mbështetur fuqishëm federatat sportive. Gjatë këtij takimi u konfirmua edhe një herë mbështetja e Federatës Evropiane të Sportit Universitar dhe jemi me fat që tashmë bashkëpunimi me të gjitha federatat evropiane po rritet dhe bashkërisht do të rrugëtojmë për fuqizimin e

rolit tonë në arenën ndërkombëtare sa i përket aktiviteteve sportive", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq presidenti i Federatës Evropiane të Sportit Universitar, Adam Roczek, e ka vlerësuar të rëndësishëm faktin se Federata e Sporteve Universitare e Kosovës është pjesë e Federatës Evropiane të Sportit Universitar. "Federata është bërë anëtare me të drejta të plota në EUSA këtë vit pas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe jemi krenarë që e kemi anëtarin e 46 në Evropë. Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet se studentët nga Kosova që prej shumë viteve marrin pjesë në garat që ne organizojmë në ombrellën e EUSA-së dhe medalja e parë është fituar nga studentët prej Kosovës", ka deklaruar

Adam Roczek. "Vizita ime në Kosovë nuk është vetëm vizitë formale. Ne do të kemi këtu një punëtori në mënyrë që të ndihmojmë dhe të këshillojmë si ta zhvillojmë sportin në universitetet e Kosovës për përfitimet e studentëve, për të mirën e shoqërisë në Kosovë", ka thënë Adam Roczek.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe kryetari i Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës, Musa Selimi, i cili deklaroi: "Është shumë e rëndësishme ardhja dhe do të jetë gërshetim i aktiviteteve tona. Kemi diskutuar rreth mundësisë së organizimit të një ngjarje të madhe sportive evropiane në Kosovë. Morëm mbështetje që në dy vjetët e ardhshëm të organizojmë një aktivitet".

## SHKURT

### Eliminohet edhe Lorian Kuka

Loriana Kuka debutoi të martën në Kampionatin Botëror të Xhudos "Baku 2018". Kuka u mposht në raundin e dytë nga sllovenia Klara Apotekar, në kategorinë -78 kilogramë. Loriana ishte garuesja e fundit nga Kosova që garoi në botëror. Kujtojmë që Nora Gjakova (-57 kg) zuri vendin e shtatë, Akil Gjakova (-73 kg) hyri në 16 më të mirët, kurse Distria Krasniqi (-48 kg) u ndal në raundin e dytë.

### Më 29 shtator turneu "Xhafer Thaçi" në boks

Më 29 shtator "KB Gjakova 137" organizon turneun tradicional ndërkombëtar në boks "Xhafer Thaçi". Në këtë turne marrin pjesë bokserët nga Shqipëria dhe Kosova. Meçet mbahen në Palestrën e Sporteve "Shani Nushi" nga ora 19:00, kurse matja zyrtare do të bëhet nga ora 11:00 - 12:00. Meçet i referojnë: Latif Demolli, Rustem Konjuhi, Aliriza Rexhepi, Agim Shala, Agron Nushi, Luan Krasniqi, kurse delegat do të jetë Sylejman Voca.

### De Biasi, afër Armenisë

Gianni De Biasi mund të rikthehet shumë shpejt të drejtojë një kombëtare, madje të një vendi ku ka festuar arritjen më të madhe të futbollit shqiptar deri më tani. Flasi për Armeninë, ekipin që Shqipëria e mundi në shtëpi për ta siguruar kualifikimin në "Francë 2016". Mediet armene bëjnë me dije se italianin ka mbërritur në vendin e tyre për të biseduar me Artur Vanetsian, presidentin e ri të Federatës Armene të Futbollit. Gianni De Biasi konsiderohet një zgjedhje e mirë për Armeninë, që momentalisht drejtohet nga Vardan Minasian.

### Eto'o: Messi më i miri në historinë e futbollit

Ish-kapiteni i Kombëtares së Kamerunit, Samuel Eto'o, beson se ish-bashkëlojtari i tij në skuadrën e Barcelonës, Lionel Messi, është lojtari më i mirë i të gjitha kohëve në historinë e futbollit. "Leo, për ne, do të mbetet gjithmonë lojtari më i mirë në botë i të gjitha kohëve. Njerëzit zgjedhën dhe ata i zgjedhën tre lojtarë të tjerë, të cilët gjithashtu kanë arritur shumë sezonin e kaluar. Por, për njerëzit si unë dhe të tjerë, kjo nuk e ndryshon faktin dhe Leo është lojtari më i mirë i të gjitha kohëve në botën e futbollit", ka thënë Eto'o.

## Hamiltoni tregon sekretin e suksesit të Mercedesit

**LONDËR, 26 SHTATOR** - Vetëm një makinë e shpejtë dhe një strategji e mirë nuk mjaftojnë për ta fituar garën dhe titullin kampion në Formula 1. I bindur për këtë është piloti britanik i Mercedesit, Lewis Hamiltoni, që shprehet se marrëdh-

ëniet dhe shkëlqyer që ekziston mes të gjithëve të makina gjermane është sekretin e fitores së "shigjetave të argjendta" në pistë gjatë viteve të fundit.

Një motor i fuqishëm, dy pilotë të jashtëzakonshëm dhe një staf

drejtuës i aftë i është bashkuar dhe një grup inxhinierësh e mekanikësh që bëjnë më së miri detyrën e tyre, duke krijuar një skuadër të përkryer. "Të gjithë po bëjnë një punë të jashtëzakonshme për të bërë të mundur që

makina që pilotojmë unë e Bottas të jetë e shpejtë. Të gjithë besojmë te njëri-tjetri", ka thënë Hamiltoni. "Ata kanë besim të plotë tek unë dhe unë tek ata. Ata e dinë se çfarë makine dua unë dhe bëjnë maksimumin për ta realizuar atë. Kjo

ndodh në çdo garë, ndaj dhe unë arrij të jem i shpejtë dhe të fitoj. Duhet që këtë mentalitet ta ruajmë gjithnjë, duke punuar fort. Unë kam besim te kjo skuadër, jemi të bashkuar dhe ky është sekretin ynë", u shpreh Lewis Hamiltoni.



## LeBron: Kemi potencialin të rivalizojmë me çdo ekip

LOS ANGELES, 25 SHTATOR - LeBron James u dukë mjaft entuziast për aventurën e tij të re me Los Angeles Lakers. Ai që konsiderohet si basketbollisti më i mirë në ditët e sotme, ka premtuar se do të japë maksimumin e tij për ekipin e ri.

"Nuk ndiej asnjë presion. Zgjedhja ime u bë duke u bazuar fillimisht te familja ime, prandaj mendova për Lakersin. Jam një lojtar basketbolli. Kur jam duke bërë atë që di më mirë, të gjitha gjërat shkojnë siç duhet", ka thënë LeBron.

"Kemi një ekip shumë të mirë, lojtarë të cilët mund të bëjnë gjëra të ndryshme. Kur ta fillojmë stërvitjen, do të jetë si dita e parë e shkollës për mua. Do të mundohemi të rivalizojmë me çdo ekip, sepse kemi potencialin e duhur", ka deklaruar ai.

Pas disa vjetësh mungesë në "play-off"-in e tërheqjes të Kobe Bryantit, Lakersi do të hyjë në një epokë krejtësisht të re për ta, me legjendën e ekipit, Magic Johnson, në rolin e presidentit e LeBron James si lider i skuadrës.



## Fetaovski synon sukses në Lojërat Olimpikë Verore

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Bleron Fetaovski është peshëngritësi i vetëm që do ta përfaqësojë Kosovën në Lojërat Olimpikë Verore për të Rinj, "Buenos Aires 2018", dhe një nga pesë sportistët që do ta përfaqësojnë vendin tonë për herë të parë në Olimpiadën e të Rinjve. Bleroni është ftuar me ftesë falë Univerzalitetit, bashkë edhe me tre sportistët e tjerë: Melisa Zhdrella (not), Erdonis Maliqi (boks), Muhamet Ramadani (atletikë), ndërsa Erza Muminović (xhudo) ka fituar normën Olimpikë. 17-vjeçari Fetaovski prej disa muajsh është duke u përgatitur për të pasur paraqitje sa më të mirë në ngjarjen më të madhe sportive për të rinj. Ai garon në kategorinë -77 kilogramë. "Bleroni është kampion i Kosovës në peshëngritje për junior", ka thënë Astrit Hasani, kryetar i Federatës së Peshëngritjes së Kosovës për faqen zyrtare të KOK-ut. Ai tregon se si e ka zbuluar talentin e Bleronit. "Në vitin 2014 së bashku me trajnerin ndërkom-



bëtar, Ilir Tafaram, e kemi identifikuar Bleronin në Shkollën Fillore 'Dardania' në Prishtinë". Pas vetëm katër vjetësh karrierë, Bleronit i është realizuar ëndrra për të marrë pjesë në Lojërat Olimpikë Verore për të Rinj. "Jam shumë i lumtur që më është dhënë mundësia të jem pjesëmarrës në Lojërat e Para Olimpikë për të Rinj, të parat për Kosovën. Synimi im është të kem paraqitje shumë të mirë", shprehhet shtatlarti Fetaovski.

Bashkë me Hasanin, që është edhe trajner, si dhe peshëngritësin tjetër, Arbnor Krasniqi, Bleroni ka udhëtuar

drejt Ankaras së Turqisë, për të zhvilluar një fazë përgatitore, falë mbështetjes që Komiteti Olimpik i Kosovës ua ka dhënë federatave, sportistët e të cilave do të garojnë në "Buenos Aires 2018". "Përgatitjet në Ankara po shkojnë shumë mirë. Jemi duke ushtruar dy herë në ditë në klubin ku kanë stërvitur yjet e peshëngritjes, Naim Sylejmanoglu dhe Halil Mutlu", ka shtuar Hasani, i cili pret që Bleroni ta thyjë rekordin personal në "Buenos Aires 2018". Rekordi i Bleronit është 190 kilogramë në total. "Përgatitjet po shkojnë shumë mirë. Jam shumë i kënaqur. Kam ushtruar shumë edhe në Prishtinë dhe tani në Ankara", thekson Bleroni, që është pjesë e Klubit Prishtina. Lojërat Olimpikë Verore për të rinj mbahen prej 6-18 tetor 2018 në Buenos Aires të Argjentinës. Për ekipin Olimpik të Kosovës do të jetë pjesëmarrja e parë që prej anëtarësimit të Komitetit Olimpik të Kosovës në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, katër vjet më parë.

## Përplasen 'Intelektualët' dhe 'Skifterat'

GJILAN, 25 SHTATOR - Në fundjavë zhvillohet derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Dritës dhe Gjilanit, kurse tifozët e këtyre dy skuadrave, "Intelektualët" dhe "Skifterat", kanë filluar garën qysh tash. "Intelektualët" e kanë vlerësuar Gjilanin një skuadër të pabarabartë për Dritën dhe e ka akuzuar se e ka "ADN"-në në Serbi. "Derbi i Anamoravës? Një ndeshje për t'u quajtur derbi duhet të plotësohen disa kushte, fillimisht duhet që dy skuadrat të kenë në sirtar tituj kampioni dhe, së dyti, duhet të kenë vite ekzistencë ose edhe histori pas vetës. Ndeshja e radhës na vë përballë një skuadre pa traditë, pa kulture, mbi të gjitha përballë kemi një skuadër që ka tentuar ta trashëgojë historinë e ekipit të shqijevë, pra nga klubi që ka 'ADN' në Serbi. Për Dritën



derbi i vërtetë janë kupat e Evropës, saktësisht Liga e Kampionëve, thjesht për një arsye të vetme, sepse nuk mund të quhet derbi kur një skuadër është provinciale e tjetra garon në garën me elitare për klube - Ligën e Kampionëve", thuhet në reagimin e "Intelektualëve". Menjëherë ka ardhur edhe reagimi i "Skifterave". Këta të fundit kanë vlerësuar se kundërshtarët e tyre nga Gjilani tashmë janë shuar. "Minoriteti i qytetit me qëllim, për t'vëtkënaqur anëtarët e vet pas disfatës së rëndë nga rivalët e tyre,

'Plisat', të cilët defiluan qetë në qytetin 'me viza', në thirrjen e derbit të qytetit, paska ushqyer me një mal gënjeshtresh tifozët e vet, duke na krahasuar me një ekip serb. Këtë retorikë të turpshme jemi mësuar ta dëgjojmë nga ta gjithmonë kur janë të shembur dhe kanë nevojë për t'u ngritur. I bëjmë me dije tifogrupit tashmë të shuar, në ndeshjen kundër KF KEK-ut nga qytetarët e Obiliqit t'i njoftojnë anëtarët e vet me parimet themelore të ekzistencës së një tifogrupi ultras, pastaj t'i thërrasin veteranët e tyre për t'ua shpjeguar origjinën e vërtetë të klubit të tyre sepse nuk na takon të mbajmë ligjëratat historie për ta. Tendencat për t'u nivelizuar me ekipe evropiane është e kotë me vetë faktin se kemi harruar kur jemi mposhtur nga ekipi i tyre", thuhet në reagimin e "Skifterave".

### SHKURT

#### Conte refuzon Romën

Antonio Conte nuk është i interesuar për postin e trajnerit të Romës. "Corriere dello Sport" raporton se ish-trajneri i Chelsea nuk planifikon të kthehet nga pushimi për ta marrë drejtimin e Romës në rast të shkarkimit të Eusebio di Francescos. Italiani është i lirë pas shkarkimit nga Chelsea dhe së fundmi spekulohet me angazhim të ri te "Giallorossët".

#### Tiger Woods fiton në PGA pas pesë vjetësh

Tiger Woods rikthehet të fitojë një turne madhor në golf në PGA pas pesë vjetësh. 42-vjeçari triumfoi në ndalesën e PGA Tour të Atlantës dhe këtë e bëri sipas mënyrës së tij, duke dominuar mbi rivalët e tij nga xhiroja e parë tek e fundit, duke dhënë një sinjal për Ryder Cup 2018 që nis këtë të premte. Për Tiger woods kjo është fitorja e tij e 80, nga të cilat 14 janë në turnetë madhorë. Objektivat e radhës së tij janë arritja dhe thyerja e rekordit të Sam Sneads që është në kuotën e 82 fitoreve, sidomos thyerja e rekordit të Jack Nicklaus që ka fituar 18 tituj në turnetë madhorë PGA. Tiger Woods nuk fitonte prej 1876 ditësh, domethënë që nga gushti i vitit 2013. Që nga momenti i rikthimit të tij në fushat e golfit pas dy ndërhyrjeve kirurgjikale në shpinë, Tiger Woods është përmirësuar ndjeshëm në paraqitjet e tij duke iu afruar fitores edhe në disa raste të tjera. Kjo ka bërë që ai të fitojë ndjeshëm pozicione në klasifikim ku kishte zbritur deri në vendin e 625-të. Me suksesin në Atlanta, Tiger Woods e sheh veten mes 20 vendeve të para në këtë renditje.

#### UEFA heton PSG-në

UEFA ka hapur një hetim mbi financat dhe shpenzimet e klubit francez Paris Saint-Germain. Kampionët e Ligës 1 fillimisht dolën të pastër nga rregullat financiare të Fair Play Financiare (FFP) në qershor, por organi qeverisës i futbollit evropian bëri me dije se vendimi do të rishikohet përsëri. Tani organi i kontrollit financiar të klubit të UEFA-s ka vendosur ta "grykojë rastin për hetime të mëtejshme". Rregullat e FFP kërkojnë që klubet t'i balancojnë shpenzimet me të ardhurat e tyre. Në gusht 2017, PSG pagoi 222 milionë euro për të nënshkruar me Neymarin nga Barcelona. Gjithashtu, nënshkroi me Kylian Mbappe për 180 milionë euro këtë verë, pasi sulmuesi francez në fillim u bashkua në formë huazimi nga rivalët e Ligës 1, Monaco.

#### Sanchezi merr 500 mijë paund në javë, por nuk ka shënuar nga marsi

Është lojtari më i paguar te Manchester Unitedi, por forma e Alexis Sanchezit vazhdon të zhgënjëjë edhe këtë sezon. Kiliani ka shënuar vetëm tri gola që prej transferimit të tij nga Arsenalin në janar. Ai nuk mbyll një ndeshje që prej 10 gushtit, ndërsa edhe mbrojtësi Chris Smalling e ka gjetur rrugën e golit tri herë, nga hera e fundit që sulmuesi 29-vjeçar ka shënuar në Premierë Ligë, në fund të muajit mars. Sanchezi ka një statistikë goditjesh në portë (2.43 për ndeshje), më e dobëta e gjithë karrierës së tij në Angli, ndërsa 1.08 goditje në portë për 90 minuta është një statistikë qesharake krahasuar me një lojtar të kalibrit të tij. Tenton 3.24 driblime për ndeshje, por të suksesshme janë vetëm 1.35, edhe kjo një shifër nën mesataren e tij. Shtypi anglez ngre pikëpyetje se deri kur do të zgjasë durimi i Jose Mourinhos në kurriz të Rashfordit dhe Martialit.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bali Canolli nga Prishtina, shpallë të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Ali Sokoli" drejtimi mjekësi e përgjithshme Prishtinë.

► Edmond Kastrati shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Ervi Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl I - V- SHFMU "Nazim Kokollari" Prizren.

► Serbezo Mujo shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Ekrem Rexha Drini" Lubizhdë.

► Bajram Xhaferi shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Selin Qenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX SHFMU "Bajram Curri" Tomajë.

► Bardha Zherka shpall të pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► D.P.T. "Inxha" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80674287 me seli në Prishtinë.

► N.P.T. "G.S.S" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70129986 me seli në Prishtinë.

► Elsa Shiqerukaj nga Tropoja, shpallë të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë (10) të shkollës SH.M.E.J "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.





**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova – Republic of Kosovo  
 Qeveria – Vlada - Government  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
 Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)  
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
 Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –  
 University Clinical Center of Kosovo  
**Sektori i Personelit**



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 paragrafi 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); nenit 13, pika 1, dhe nenit 15, paragrafi 3 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; nenit 5 paragrafi 1 e 2 i rregullores nr. 1003/2016; Kërkesës nr. 4827 datë 24.09.2018; Qendra Klinike Universitare e Kosovës, publikon:

**K O N K U R S**

Nr.	Shërbimi i Infermierisë së QKUK-së	Janë kërkuar	
		Të rregullta	Koeficienti
1.	Infermierë të Përgjithshëm – Bachelor Infer.	30	5.4
2.	Infermierë të Përgjithshëm – Shkolla e mesme	32	4.8
3.	Teknikë të Rentgenit - Bachelor	3	5.4
4.	Teknikë të Rentgenit me shkollë të mesme	3	5.4
5.	Laborantë – drejtimi mjekësor – Bachelor -Biokimi – Mikrobiologji	3	5.4
6.	Laborantë – drejtimi mjekësor – Sh.mesme për Institutin e Patologjisë	3	5.4

Nr. Referencës QKUK – 28/2018-10/74

**Qëllimi kryesor i vendit të punës: (për të gjitha pozitat)**

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kuptimin cilësor e sasior, bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

**I. Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësive për infermierë (Bachelor) të përgjithshëm - Bachelor:**

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët,
- Zbaton politikat integruese dhe udhëzimet organizative për standardet profesionale,
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe departamentin ku punon,
- Të caktojë, planifikojë, zbatoj dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar,
- Merr pjesë në zhvillimin profesional për të rritur / zhvilluar praktiken infermierike,
- Sipas nevojës t'i asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit,
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët,
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës,
- Të iu jap pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre,
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punojë gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale,
- Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit,
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet,
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve,
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor,
- Të ruajë kufidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale,
- Gjithnjë të veprojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonte në avancimin e marrëdhënieve të mira pacient - infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike,
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë,
- Punon dhe bashkëpunon me profesionistët tjerë shëndetësor duke përdorur mekanizmin për monitorimin e rezultateve të kujdesit ndaj pacientit,
- Lehtëson koordinimin e kujdesit për të arritur rezultatet e shëndetit,
- Zbaton protokollin e praktikave infermiere të bazuara në dëshmi, gjatë ofrimit të kujdesit infermieror,
- Përdor dhe kontribuon në hulumtime që ndërlidhen me dëshmitë për siguri dhe praktikën efektive dhe efikente.

**II. Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësive për infermierë të përgjithshëm (Shkolla e Mesme):**

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe departamentin ku punon.
- Të caktojë, planifikojë, zbatoj dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Të kolektojë të dhëna të sakta mbi pacientin sipas specifikave të infermierit/teknikut përgjegjës.
- Sipas nevojës t'i asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit.
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës.
- Të iu jap pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre.
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punojë gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale,
- Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit,
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet,
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve,
- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor,

- Të ruajë kufidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e pacientit apo punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo /ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale,
- Gjithnjë të veprojë në mënyrë të tillë, që do të ndihmonte në avancimin e marrëdhënieve të mira pacient - infermier/e,
- Të marrë pjesë në aktivitetet për edukimin e vazhdueshëm profesional në mënyrë që të freskojë dhe avancojë njohuritë dhe standardet e punës infermierike,
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë.

**III - IV. Përshkrimi i punëve dhe detyrave për Teknikë të Rentgenit (me Shkollë të Mesme dhe më Baçelor):**

- \* Tekniku i Radiologjisë do të punojë si pjesëtar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientin,
- Të sigurojë pastërtinë dhe higjienë e mjediseve klinike dhe gjithnjë t'u përmbahet udhëzuesve për kontrollin e infeksionit,
- Gjithnjë t'u përmbahet udhëzuesve mbi mbrojtjen radiologjike të pacientëve dhe personelit,
- Të kujdeset për një ambient të sigurt për gjithë pacientet dhe kolegët,
- Të menaxhojë mbeturinat në përputhje me politiken spitalore,
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politiken spitalore,
- Të marrë pjesë në planifikimin e kujdesit ndaj pacientit,
- Të marrë, shfrytëzojë, mirëmbajë dhe ruajë në mënyrë të sigurt dhe të duhur të gjitha informatat dhe pajisjet.
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve të shkruar mbi procedurat klinike.
- Të asistojë në vlerësimin e efikasitetit të intervenimeve klinike
- Te mbledhë dhe raportojë mbi të dhënat e nevojshme, në përputhje me politiken spitalore
- Te marrë pjesë në mbledhjet e ekipit klinik, kur trajtohen çështje relevante për këtë profil pune,
- Të sigurojë që i gjithë stafi e ka mundësinë të shprehe mendimin dhe sugjerimet lidhur me përmirësimin e punës dhe mjedisit të punës,
- Te ruaj nivelin e standardit të punës profesionale dhe të punojë në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të Shoqatës Infermierike të Kosovës,
- Të ruajë konfidencien absolute lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pacientin dhe spitalin, përveç se në rastet kur kjo është aprovuar me shkrim, në përputhje me politiken spitalore,
- Gjithnjë, te veprojë në atë mënyrë që do të ndikonte në promovimin e marrëdhënieve të mira pacient –infermier/e,
- Te marrë pjesë në aktivitetet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, me qëllim të freskimit dhe avancimit të njohurive dhe standardeve të punës profesionale.

**V - VI. Përshkrimi i punëve dhe detyrave për Laborantë – drejtimi mjekësor (me Baçelor dhe me Shkollë të Mesme):**

- Tekniku laborant do të punojë si pjesëtar i ekipit të kujdesit mjekësor, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientin,
- Varësisht nga testet që kryen në laborator, të marrë, përgatisë, analizojë dhe asgjësojë në mënyrë të sigurt të gjitha mostrat klinike,
- Te mbajë të dhëna të sakta mbi pacientet, ashtu si do të specifikohet nga infermieri/tekniku përgjegjës,
- Të kryejë të gjitha procedurat dhe detyrat e deleguara, në përputhje me politiken e aprovuar,
- Të kujdeset për një ambient të sigurt për të gjithë pacientet dhe kolegët,
- Të sigurojë një komunikim të mirë mes personelit gjatë dorëzimit të detyrës në përfundim të orarit të punës, duke siguruar të dhëna të sakta mbi pacientet e trajtuar gjatë orarit të tij/saj të punës,
- Ne rastet kur kjo është e mundur, t'u japë pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesit që iu ofrohet atyre,
- Te përdorë, mirëmbajë dhe ruajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet,
- Te marrë pjesë në mbledhjet e ekipit klinik, kur trajtohen çështje relevante për këtë profil pune,
- Te marrë pjesë në programet e përpiluara për njësi të veçanta, me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informatave mes personelit infermierik,
- Te ruaj nivelin e standardit të punës profesionale dhe të punojë në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të Shoqatës Infermierike të Kosovës,
- Te ruajë kufidencialitetin absolut lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pacientin dhe spitalin, përveç se në rastet kur kjo është aprovuar me shkrim, në përputhje me politiken spitalore,
- Gjithnjë, te veprojë në atë mënyrë që do të ndikonte në promovimin e marrëdhënieve të mira pacient –infermier/e,
- Te marrë pjesë në aktivitetet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, për të freskuar dhe avancuar njohuritë dhe standardet e punës profesionale.

**I. Kushtet e kërkuara për kategoritë më Bachelor - fotokopje:**

- Diploma e Fakultetit të Infermierisë së Përgjithshme, Laborantë– Drejtimi Mjekësor,
- Licenca e punës: – nga Ministria e Shëndetësisë nga lëmia përkatëse me Bachelor,
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve,
- Leje njoftimi – fotokopje,
- Njohja e kompjuterit (word dhe excel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisë, rekomandime specifike, etj.

**II. Kushtet e kërkuara për kategoritë më Shkollë të mesme - fotokopje:**

- Diploma e Shkollës së Mesme e Mjekësisë të Infermierisë së Përgjithshme, Teknikë të Rentgenit dhe Laborant – Drejtimi Mjekësor,
- Licenca e punës: – nga Ministria e Shëndetësisë nga lëmia përkatëse me Shkollë të Mesme të Mjekësisë drejtimi përkatës,
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve,
- Leje njoftimi – fotokopje,
- Njohja e kompjuterit (word dhe excel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisë, rekomandime specifike, etj.

**Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.**

Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

- Përvoja e punës do të këtë përparësi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas këtij konkursi.

**Procedurat e konkurrimit:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit**

Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do t'i nënshtrihen testit me shkrim, dhe të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtruar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit përzgjedhës. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitojë çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).

**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t'i bëni në 038 / 512 - 667

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)  
Univerzitetit Bolniçke i Klinikë Službe Kosova (UBKSK)  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)  
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universiteti Klinikë Centar Kosova –  
University Clinical Center of Kosovo  
Sektor i Personelit



